



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.10.2018 ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 12 tetor – 23 nëntor 2018.
Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 15 tetor – 2 nëntor 2018.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim / Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane

Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Marrin pjesë:

Mimoza Pano -	Drejtores e Shërbimit të Seancës Plenare
Mimoza Arbi -	Drejtores e Shërbimit Juridik

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Të nderuar anëtarë të Konferencës së Kryetarëve. Hapim mbledhjen me këtë rend dite: miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 15 tetor - 23 nëntor 2018 dhe miratimi i kalendarit tri javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 15 tetor - 2 nëntor 2018

Me projektprogramin dhe projektkalendarin besoj jeni njohur në rrugë elektronike. Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, projektrezolutë etj. Të gjitha materialet i keni përpara.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Janë parashikuar 3 seanca plenare përkatësisht në datat: 18 tetor 2018, ora 10:00 (*e enjte*), 25 tetor 2018, ora 10:00 (*e enjte*) dhe 1 nëntor 2018, ora 10:00 (*e enjte*).

Në mbledhjet e kaluara kam vënë në vëmendjen tuaj dy probleme të cilat dua t'i ritheksoj sërish:

➤ **Së pari**, komisionet kur të bëjnë programin e tyre të punës të mos fokusohen vetëm tek projektligjet që janë parashikuar për në seancë plenare, por të programojnë edhe shqyrtimin e projektligjeve që nuk janë parashikuar për këto 3 seanca plenare, po janë si punë në komisione.

➤ **Së dyti**, Komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës për projektligjet e reformës në drejtësi të përshpejtojë punën për të mbyllur shqyrtimin e projektligjeve të depozituara, me qëllim kalimin sa më shpejt në seancë plenare për miratim.

➤ **Së treti**, ju njoftoj se Këshilli i Ministrave ka tërhequr nga shqyrtimi 4 projektligje si më poshtë:

- *Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, të ndryshuar”*
- *Projektligjin për pullat fiskale dhe pullat e kontrollit të barnave*
- *Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar*
- *Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit””, të ndryshuar*

➤ **Së katërti**, përpara keni Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë. Ky Plan Veprimi është përgatitur nga shërbimet e Kuvendit bazuar në raport progresin e Komisionit Europian. Ju kërkoj angazhimin maksimal për realizimin në kohë dhe me cilësi të masave të parashikuara në këtë Plan Veprimi me qëllim arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës së Kuvendit.

Lidhur me programin dhe kalendarin çfarë sugjerimesh keni për materialet e paraqitura?

Ulsi Manja –Në program janë vënë 1) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, 2) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, 3) Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar dhe 4) Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar. Për datën 25 tetor janë gati vetëm Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar dhe Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, ndërsa dy të tjerat nuk janë gati për datën 25 tetor. Diskutimin për ligjin “Për noterinë” e filluam dje nën për nen. E shtymë për javën tjetër sepse një ditë më përpara erdhën me dhjetëra sugjerime dhe argumente nga ministria e Drejtësisë që gati gati ndryshonin 50% të thelbit të ligjit dhe ne u detyruam që ta shtyjmë dje shqyrtimin nën për nen për të mbyllur draftin. Grupet e punës kanë punuar, Vasilika si relatore me ministrinë e Drejtësisë, ndërsa ligjin e noterisë e bëjmë gati për datën 28. Ligjin “Për Avokaturën e Shtetit” dhe ligjin “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” nuk i bëjmë dot gati.

Vasilika Hysi – Kryetar, në kalendar dhe program është projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe që është përcaktuar me datë 1 nëntor. Numri i sugjerimeve që duhet të reflektohen në Rregullore është shumë i madh, pasi nuk është thjesht reflektim i paketës së ndryshimeve kushtetuese, por nga projekti IPA kanë ardhur një sërë rekomandimesh, të cilat janë gati 55 fletë, në mos gaboj, që ka shumë rekomandime për Rregulloren. Duhet më shumë kohë që të punohet dhe stafi i Kuvendit ka punuar, i ka draftuar, por do ishte mirë që ato të konsultoheshin, sepse kanë të bëjnë me angazhimin e vendit në kuadrin e Integritetit Europian, kanë të bëjë me kontrollin parlamentar, kanë të bëjnë me menaxhimin e brendshëm të punës së stafit. Por, do ishte mirë që një konsultim të bëhej jo vetëm në Këshillin e Rregullores, por edhe me kryetarët, nënkryetarët dhe sekretarët e komisioneve, pasi një pjesë e neneve që propozohen lidhen me punën e tyre. Kush më mirë se kryetarët e komisioneve mund të kontribuojnë për ta përmirësuar këtë Rregullore që të jetë funksionale, por që të rrisë dhe transparencën e Kuvendit dhe gjithë atë punë që ne bëjmë dhe që realisht nuk gjen pasqyrim, të rregullohet në Rregullore dhe të pasurohet e të bëhet publike.

Do të sugjeroja, ndoshta dhe Moza që është pjesë e grupit të punës të mund të na japë një datë se kur ne mund të jemi më të gatshëm, mos harrojmë që opozita nuk ka kontribuar dhe puna mbetet tek deputetët të tjerë. Nga deputetët që kemi ngarkuar mbetëm vetëm Unë, z. Petrit Vasili nuk ka ardhur edhe z. Florjon Mima me z. Enkelejd Alibeajn nuk kanë ardhur gjithashtu.

Mimoza Pano – Nga z. Enkelejd Alibeaj kemi komente për draftin e parë, i cili është i datës 2 prill 2018. Aty ka mbetur puna, sepse opozita nuk u përfshi më dhe një pjesë e komenteve të z. Alibeaj të asaj periudhe kanë gjetur reflektim. Dakord, ne po e shohim edhe njëherë me synimin për të reflektuar rekomandimet e IPA-s.

Vasilika Hysi – Vetëm komentet, draftimet po i bëjmë vetë!

Ermonela Felaj – Lidhur me Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” kam një merak që do të doja ta ndaj me Konferencën e Kryetarëve. Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” është shumë i rëndësishëm dhe do të sugjeroja që nuk duhet të nxitojmë në bërjen e këtij ligji.

U diskutua një draft në të dy komisionet, në komision të Ligjeve dhe të Sigurisë, i cili është duke ndryshuar tërësisht. Ajo çka më shqetëson është se ne po ndryshojmë komplet

mënyrën se si funksionon prokuroria. Ende nuk kemi organin që merret me emërimet, disiplinimin dhe shkarkimet. Futemi në një moment në policinë gjyqësore kur nuk e kemi ristrukturuar akoma këtë që e keni marrë si nisën 2 vite më parë. Ajo çka më shqetëson është se ne nuk kemi ndarë faturën financiare të këtij ligji. Nëse deri më sot për mbi 20 vjet ka një raport të rrogës së oficerit të policisë gjyqësore me prokurorët, ku oficerët marrin 60% të rrogës së prokurorëve ky raport tani në ligj nuk ruhet. Ne kemi rritur rrogat e prokurorëve dhe gjyqtarëve, ende nuk ka hyrë në fuqi, por kur bëjmë një projektligj të ri për policinë gjyqësore nuk mund të marrim më parasysh këtë aspekt, pasi i bie që ne të shkatërrojmë thelbin e hetimit. Hetimin e kanë këta njëerëz, nuk do ta kenë më njerëz të tjerë, prandaj mendoj që t'i japim pak më shumë kohë vetës që të sigurohemi që e përballojmë këtë faturë financiare. Na ka ndodhur që miratojmë gjëra në Kuvendin e Shqipërisë, siç është “Statusi i naftëtarit” ku Ju e dini shumë mirë që edhe sot e kësaj dite akoma nuk zbatohet ky ligj. Askush akoma nuk ka marrë asnjë lloj përfitimi financiar.

Gramoz Ruçi – Cili është problemi?

Ermonela felaj – Problemi është se data 1 nëntor është një datë e pa arritshme për ta miratuar në parlament këtë ligj dhe e dyta është që t'i japim pak kohë vetës që ta shikojmë me kujdes. Nuk kemi përse të bëjmë një nxitim kaq të madh.

Gramoz Ruçi – Ne kemi 2 vjet me këtë ligj? Çfarë nxitimi thua!

Ermonela Felaj – Nxitim kemi ne...

Gramoz Ruçi – Çfarë nxitimi kemi ne, po e mbajmë draftin prej 2 vitesh nëpër tavolina!

Ermonela Felaj – Akoma nuk e kemi përmbyllur.

Gramoz Ruçi – Ç'punë ka prokuroria këtu! Çka KLGJ-ja dhe KLP –ja këtu!

Ermonela Felaj – Të gjitha kompetencat këta do t'ia japin një organi që ende nuk është krijuar.

Gramoz Ruçi – Kush nuk është krijuar?

Ermonela Felaj – Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk është krijuar. Edhe teksti për hir të së vërtetës është një tekst shumë herë më i dobët sesa teksti aktual që kemi ne për policinë gjyqësore. Tani unë po e ndaj se e kam shqetësim, por Ju edhe mund ta bëni, por jam e bindur që do të kemi më shumë probleme se në të shkuarën.

Ulsi Manja – Të sqaroj unë diçka, nuk kemi asnjë lloj nxitimi. Ligji ka dy vjet që rri në komision. Tani grupi i punës është duke i dhënë fund draftit. Janë ekspertët e EURALUS-it, ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme që po e mbajnë ligjin. Është e vërtetë që ka pasur disa variante të këtij drafti dhe dy gjëra kanë qenë për t'u diskutuar në këtë draft. Çështja e trajtimit financiar të oficerëve të policisë gjyqësore dhe sistemi i karrierës i policisë gjyqësore. Nuk është se ne do t'ia japim KLP-së sistemin e karrierës së policisë gjyqësore, as nuk ka qenë ndonjëherë dhe as do të jetë sepse nuk mund t'i japim KLP-së një kompetencë që nuk ia ka dhënë Kushtetuta. As Prokurorit të Përgjithshëm nuk mund t'i japim një kompetencë që nuk ia ka dhënë Kushtetuta.

Ndërsa çështja e trajtimit financiar është e vërtetë që sot trajtohen me ligjin aktual me 60% të pagës së prokurorit, por nëse pas janarit 2019-të paga e prokurorit shkon në limite goxha të larta, ministria e Financës ka vënë në diskutim nëse duhet të jetë në diskutim 60% e pagës së re e prokurorit apo s' duhet të jetë sepse ka faturë financiare të papërbalueshme. Gjithsesi, ne nuk është se e kemi ndarë në ligj, që do të jetë 60%, do jetë 70% apo nuk do jetë fare. Aktualisht e ka dhe mendimi ynë është që të paktën ky raport që është sot në ligjin aktual të ruhet dhe në ligjin që do të vijë, pasi në fund të fundit funksioni i policisë gjyqësore, me ligjet e reja të reformës, u është mbyllur sistemi i karrierës. Ata nuk mund të ecin më, nuk mund të gradohen prokurorë dhe nëse ne do të shërbejmë dhe tek paga pastaj, i bie që cilësia e hetimit të bjerë.

Erjon Braçe – Për ligjet që janë tek komisioni Ekonomisë nuk kam ndonjë gjë. Buxheti faktik është programuar për javën tjetër dhe të martën ai mbyllet bashkë me raportimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Për sa i përket projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit", të ndryshuar", që është dhe nismë ligjvënëse e imja. Ligji në thelb ka totalisht shëndetin dhe asnjë gjë tjetër, mund të ketë nene që mund të kenë detyrime që me programet arsimore t'i shpjegohet fëmijëve rreziku që i vjen nga pijet e gazuara, pijet energjike e tjerë me radhë, por jo më shumë se kaq. Prandaj po mendoja se do të ishte mirë që ligji të diskutohet në komisionin e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, si komision përgjegjës, por kam dyshime se në datë 18 tetor nuk mund të arrihet, pasi ky komision nuk është javës tjetër.

Taulant Balla – Ligji të kalojë edhe në komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pasi do kalojë nëpërmjet programeve mësimore. Do të isha dakord sikur të

përfshihej dhe komisioni i Integritetit, pasi kjo që ke bërë Ti ka edhe direktiva të BE-së për këtë punë.

Erion Braçe – Këtë kisha në lidhje me kalendarin. Kam edhe një shqetësim të cilin dua ta ndaj këtu. Unë jam ndër ata deputetë që kërkoj informacion nëpër institucione që lidhen me punën apo zbatimin e ligjeve që ne kemi miratuar, një prej të cilave është dhe ligji “Për statusin e naftëtarit”. Tani nuk bën sens që përgjigja që vjen nga institucioni qeveritar të jetë: “Nuk jemi ne institucioni kompetent për këtë gjë”!

Po të hapësh ligjin është shumë e qartë dhe e shkruar e zeza mbi të bardhë që ngarkohet filan ministri dhe filan ministri për zbatimin e këtij ligji. Ka dhe më keq akoma, që dy orë pasi vjen letra në adresën time, shkoj në një mbledhje dhe ministri është kompetenti në tavolinë! Tani kjo nuk bën sens, nëse duan të përgjigjen le të përgjigjen. Janë ligje që dëgjueshmëria publike përtë cilat normalisht ka një impakt shumë të madh dhe shumë të gjerë, siç është dhe ligji “Për statusin e naftëtarit”. Ka një debat në mes që ka të bëjë drejtë për drejtë me numrat, me faturën e të tjerë me radhë. Nëse Kuvendi apo deputetët nuk vihen në dijeni të këtyre gjërave. Nuk e kuptoj, buxheti ka nevoja e të tjera me radhë siç e përmendët dhe Ju këtu, por e kemi thënë e stër thënë për drejtësinë do paguajmë. Ato ligje që miratohen në Kuvend do paguhën, nëse nuk paguhën atëherë ta marrim dhe ta kthejmë mbrapsht ligjin, të rrëzojnë ligjin! Çfarë kuptimi ka që ligji ka 1 vit e ca në fuqi dhe nuk zbatohet! Faleminderit.

Gramoz Ruçi – Qartë.

Vasilika Hysi – Faleminderit zoti Kryetar!

Në vazhdim të idesë së Erionit dhe do të doja ta falënderoja për nismën e ndërmarrë, por unë kisha dhe një sugjerim. Dje Komiteti i Monitorimit në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës ka diskutuar një rezolutë për respektimin e të drejtave të fëmijëve, ku çështja e mbrojtjes së fëmijëve edhe nga abuzimi nga alkooli etj. ka qenë një nga detyrat që na është lënë. Rezoluta besoj se do bëhet publike sot ose nesër. Këtë informacion e mora nga dy kolegët tanë që janë aktualisht në Asamble. Do të ishte mirë që këtë nismë ta diskutonim edhe në grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve” me një arsye të thjeshtë, sepse këtë javë vjen projekt-raporti që Qeveria Shqiptare do dorëzojë në Komitetin për të Drejtat e Fëmijëve në Gjenevë. Një nga rekomandimet e lëna në raportin e fundit të vitit 2012-të është mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, përfshi alkolin dhe drogën. Në këtë mënyrë ne ushtrojmë dhe formën e kontrollit parlamentar dhe të angazhimit të parlamentarëve, që e kemi marrë në

rezolutë. Pra do kemi një mbledhje për raportin që do shkojë në Gjenevë, do të ishte mirë, meqenëse do kemi edhe përfaqësues të institucioneve, kjo ishte çështja e parë.

Çështja e dytë, nëse nuk kemi gjë për kalendarin.

Erion Braçe – Ja ta them unë Vasilika. Jam shumë i lumtur që Komiteti do ta mbështesë këtë nismë që kemi ndërmarrë ne, por do t'iu lutesha shumë për shkak edhe të ngarkesës së madhe që ka komisioni i Ekonomisë që unë të mos sorollatem nga një komision në tjetrin. Nëse do jemi te komisioni tek komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, të mbledhemi të gjithë atje dhe të bëjmë një mbledhje të përbashkët dhe e mbyllim aty diskutimin, për të evituar shëtitjet nga një komision në tjetrin për të thënë të njëjtat gjëra.

Vasilika Hysi – Mund të jetë e përbashkët? Është e përbashkët dhe këtu ftojme edhe shumë deputetë të cilët nuk janë pjesë e komisioneve që janë përgjegjëse.

Çështjen e dytë që do të doja të diskutoja kryetar lidhet me shqetësimin shumë të drejtë të Erionit për kontrollin parlamentar të deputetëve. Ka rezultuar që shumë deputetë bëjnë letra drejtuar institucioneve dhe kanë marrë përgjigje, por pak reflektohen në raportin vjetor por që ne duhet të dorëzojmë. Do të kisha një kërkesë për të gjithë kryetarët e komisioneve dhe të nënkomisioneve, që nëpërmjet sekretarive të tyre të raportojnë letrat që kanë dërguar dhe nëse kanë marrë përgjigje, por një pjesë e letrave kalojnë nëpërmjet sekretarëve të Grupeve Parlamentare, një pjesë i kalojnë komisioneve, një pjesë i çojnë direkt. Ato i marrim nga Protokolli ne, por ka një pjesë që ne nuk i marrim dot nga Protokolli. Duke qenë se ne kemi dhe Senidën në Konferencën e Kryetarëve dhe është person kontakti në mekanizëm, është shumë mirë për t'i çuar gjithë informacionin edhe për letrat që shpesh herë janë thjesht klishe përgjigje dhe nuk japin informacion për atë që kërkohet. Nga ana tjetër shqetësimi që ju ngritët zoti Kryetar për planin e veprimit të miratuar me 44 masat është e vërtetë, por deri tani kryetarët e komisioneve nuk kanë sjellë një kalendar të veprimtarive se çfarë do bëjmë ne në kuadër të screaming. Është bërë nga stafi i Kuvendit një kalendar shumë i mirë, por ai kalendar është për t'u zbatuar në pjesën më të madhe, 80%, nga deputetët dhe pak nga administrata e Kuvendit, çka do të thotë kryetarët e komisioneve sidomos komisionet që lidhen me çështjet e Integritit, Këshilli i Integritit Evropian por edhe komisionet e tjera, të kemi një kalendar që ne të raportojmë në mënyrë sistematike. Jemi në një situatë që bëhet punë dhe nuk raportohet, sepse nuk evidentohet ose disa komisione kanë më shumë angazhim disa të tjerë nuk kanë, ndërkohë që ka masa që varen nga të gjitha komisionet.

Gramoz Ruçi – Ka gjë tjetër? Nuk ka. Katër gjëra kam unë:

E para, për Rregulloren e Kuvendit. Të shpërndahej të gjithëve, por në mënyrë të veçantë Kryetarëve të Komisioneve dhe Grupeve Parlamentare dhe relatorët përkatës janë miratuar me sugjerimin që deri në këtë kohë..., të caktohet një kohë për të sjellë komentet e tyre. Pavarësisht merr pjesë apo nuk merr pjesë opozita në komisione apo seanca, Rregullorja është e Kuvendit, kështu që ne do të jemi disponibël, pastaj marrin pjesë apo nuk marrin pjesë, është e drejta e tyre. Ne duhet ta miratojmë Rregulloren sipas afateve që kemi të parashikuara në planin e veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në progres-raportin e fundit.

Problemi i dytë, lidhur me projektligjet e Reformës në Drejtësi tërheq vëmendjen. Ne duhet ta përmbyllim patjetër në këtë sesion parlamentar të gjitha çështjet që kemi. Teza që të mos nxitohemi duhet përkthyer të mos vonohemi se kemi dy vjet që i kemi vonuar këto ligje. Nëse ka ndërmend ministria përkatëse të japi mendimet, le t'i japi mendimet. Në asnjë mënyrë të mos shkëputen kontaktet dhe të mos krijojnë problemet me dy misionet që kanë asistuar në Reformën në Drejtësi, të jemi korrektë.

E treta, nëse ka faturë për p/ligjin e policisë gjyqësore, menjëherë t'i bëhet shkresë qeverisë, ku ajo të përgjigjet brenda muajit. Nëse nuk përgjigjet do miratohet projektligji siç është. Zonja Zv. Kryeministre, kështu thotë Rregullorja e Kuvendit dhe njëherë t'u përcillet kërkesa e tyre, urdhëroni kjo është fatura. Le të përgjigjen pozitivisht apo negativisht, pastaj Kuvendi do të vendosë për të.

Mimoza Pano – Kryetar lidhur me faturën i është dërguar projektligji me shkresë për t'u shprehur Qeveria për faturën dhe kanë kthyer përgjigje.

Mimoza Arbri – Përgjigjet i kemi marrë nëpërmjet ekspertëve për faturën financiare që do ketë ligji për ta diskutuar në komision. I është dërguar Ministrisë së Financës dha na ka ardhur një përgjigje nga ekspertët që merren me llogaritë e faturës dhe ato kanë dhënë 3 alternativa midis 50 apo 70 % dhe kanë përcaktuar edhe vlerën e kostos që do përfshihen. Vlerën e kanë lënë në vlerësimin e komisionit

Gramoz Ruçi – Nuk paska dalim 50, 70..... Qartë. Lidhur me këtë nismën e Erionit.

E para, të shtyhet për të kapur një datë tjetër një javë më pas. Ajo konsulta të bëhet dhe ato mbledhjet e komisionit mund të bëhen edhe të përbashkëta, nëse doni të fitohet koha.

E katërta, që kam është lidhur me kontrollin parlamentar. Zonja Zv. Kryeministre, konstatojmë që parlamenti miraton ligje. Në fund të ligjeve rëndësi ka të dalin aktet normative dhe udhëzimet që janë të detyrueshme për t'u nxjerrë. Konstatojmë që nuk kanë dalë. Në këtë këndvështrimin duhet ta shikoni Ju problemin, por unë do të kërkoja veçanërisht nga Kryetarët e Komisioneve, por jo vetëm, edhe administrata e Kuvendit, që t'i marrë ligjet çfarë kemi miratuar në këtë legjislaturë një për një. Themi ligji i miratuar në shtator të 2017-ës ka pasur afatin për gjashtë muaj deri në aktet nënligjore (nuk kanë dalë). Kush e ka përgjegjësinë? Filan Ministri. Ky ligj, ky ligj me radhë të gjithë ligjet. Të bëjmë një skaner të gjithë ligjeve që kemi miratuar deri më sot dhe ajo do të bëhet objekt diskutimi deri në seancë plenare. Ta kemi të qartë. Se miratojmë ligje dhe që për ligjet nuk merret njeri me to se aparatet e Ministrive, Ministrisë se vënë ujin në zjarr për çështjet. Kjo do të thotë që rrahim ujin në hava të gjitha. Këtu fillon pastaj, se është si histori e kambanës... pse nuk bie kambana, janë 12 arsye, por mungon kambana. Dhe e fundit që kam lidhur me planin e veprimit, menjëherë duhet ta merrni dhe të bëni kalendarin dhe duhet ta ndiqni me shumë përgjegjësi. Në qoftë se predikoni qershori, qershori..., qershori këtu fillon. Sa serioz jemi në parashikimin e planit të veprimit dhe çfarë po bëjmë për zbatimin. Prandaj, ju lutem shumë të gjithë Kryetarët e Komisioneve ta marrin planin e veprimit dhe të bëjnë planet e tyre me qëllim që ato të gjejnë zbatueshmërinë e Kuvendit, mos ketë asnjë pikëpyetje lidhur me çështjen e planit të veprimit tonë.

Erion Braçe – Që të mos harroj sot data 11 apo 12 tetor, në fund të këtij muaji minimalisht duhet të vijë dekreti për kryetarin e KLSH-së, është shumë i rëndësishëm që ai institucion të vijë.

Gramoz Ruçi – Ua kemi dërguar shkresën.

Erion Braçe – Ok, mirë.

Gramoz Ruçi – Dakord atëherë këtu e mbylлим. Të reflektohen të gjitha çka u thanë në mbledhje.

MBLEDHJA MBYLLET